



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, më datë 04.09.2019, shpallë :

K O N K U R S **PËR MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA**

I. ROJE PYLLI (2 ekzekutues)

Drejtoria: Drejtoria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë

Paga mujore(bruto)- 300.00€

Numri i referencës së vendit të punës:08-103/02-28518/19

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Të ruaj dhe parandalojë vjedhjen, shkatërrimin, dëmtimin e drurëve, kulturave pyjore, pyllëzimet dhe produktet jodrunore;
2. Të legjitimoj personat që janë duke ndërmarrë veprime në pyje dhe toka pyjore në kundërshtim me Ligjin për pyjet, të konfiskojë masën drunore të prerë ilegalisht, mjetet me të cilat është kryer prerja
3. Të kontrolloj të gjitha llojet e automjeteve dhe ngarkesat tjera me të cilat transportohet druri dhe prodhimet jodrunore dhe vendet ku dyshohet se mund të ketë masë drunore të prerë ilegalisht
4. Kujdeset për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, parandalon gjuetinë jo ligjore, përkujdeset për mbrojtjen e kafshëve të egra dhe objekteve përcjellëse;
5. Raporton te organi përgjegjës komunal për mbrojtjen e pyllit;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Përveç kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta,

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Diplomë e shkollës së mesme
- Përvojë pune (e dëshirueshme)
- Shkathtësi në komunikim ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”-MSHV

Kohëzgjatja e emërimit : Tre (3) muaj

Data e mbylljes së konkursit; mbetet i hapur 7 ditë nga dita e publikimit, prej **04.09.2019** deri më **10.09.2019**.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhës dhe në web-faqen komunale . Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e shkollës së kryer apo kopjen e vërtetuar të diplomës, vërtetimin e përvojës së punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, dëshminë se nuk është nën hetim..

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë” .

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi